



Save the Children

Një botë ndryshe

Buletin i përtremuajshëm i organizatës “MEDPAK”

Adresa: Rruga “Sh. Ishmi”, Pallati 38 Shkalla I Apt 2, Tirane

E-mail: info@medpak.org / www.medpak.org

Për më shumë informacion kontaktoni në tel me nr 042345028 dhe 0693577247

Përmes informacioneve që përmban buletini “Një botë ndryshe”, prindërit, punonjësit e arsimit, nxënësit dhe anëtarët e tjerë të komunitetit do të informohen rreth kuadrit ligjor, çështjeve që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara, detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve arsimore, institucioneve të tjerë që punojnë në fushën e arsimit gjithëpërfshirës, prindërve dhe aktorëve përgjegjës. Në rubrikat e buletinit mësuesit, prindërit, dhe vet nxënësit do të kenë mundësi të ndajnë përjetimet, eksperiencat dhe mbresat e tyre përmes shkrimeve dhe mesazheve që ata do të dërgojnë.

Ju ftojme t'i bashkoheni nismës tonë për t'i ofruar lexuesëve në mënyrë të vazhdueshme shkrime dhe artikuj, të cilët do të sjellin në vëmendje çështje që lidhen drejtpërsëdrejti me fëmijët me aftësi të kufizuara dhe të drejtat e tyre për t'u arsimuar sikurse dhe bashkëmoshatarët e tyre në kopshte e shkolla gjithëpërfshirëse.

Ky buletin del në kuadër të projektit: “Promovimi i të drejtave të fëmijëve në arsim dhe zhvillimi tërësor i tyre”, i cili po zbatohet nga “Save the Children” në partneritet me Shoqatën “MEDPAK” dhe Drejtoritë Arsimore Rajonale të qyteteve: Korçë, Vlorë, Gjirokastrër, Dibër, Elbasan, Burrel, Durrës.

Projekti ka për qëllim promovimin e të drejtës për arsim dhe zhvillimin tërësor të fëmijëve, duke parandaluar çdo formë diskriminimi ndaj tyre. Projekti zbatohet në 14 shkolla 9 vjeçare: Qemal Mici, Durrës, “Najzi Mastori”, Sukth, “Avni Rustemi”, Vore, “Fadil Gurmani”, Elbasan, “Vasil Belshi”. Shtermen, “Urani Rumbo”, Gjirokastrë, “31 Korriku” dhe “Ali Metra”, Burrel, “Demir Gashi” dhe “Haki Stermilli”, Dibër, “Sevasti Qiriazi”, Korçë, “Balil Perlari”, Vlorë.

Për të realizuar qëllimin e lartpërmendur puna është fokusuar në disa drejtime: në rritjen e nivelit të informimit dhe ndërgjegjësimit të aktorëve përgjegjës mbi zbatimin në praktikë të arsimit gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara, në ngritjen dhe konsolidimin e komisioneve të njësive vendore arsimore, të cilat kanë në përbërje të tyre: specialiste të arsimit, punonjës të shërbimit psiko-social në shkolla, mësues, punonjës të zyrave të shërbimi socialë në bashkitë përkatëse, si dhe punonjës shëndetësie (mjek specialist).

Një shok ndryshe

Kur erdhi ne klasën tonë, ne nuk e dinim se ai ishte një fëmijë me autizëm, madje as nuk kishim dëgjuar më parë se ç'ishte autizmi.

Mësuesja që në fillim tregoi një kujdes të veçantë për të, e uli në bankë të parë, na kërkoi të mos e ngacmonim Andrean, por t'a mbështesnim e ndihmonim pasi ai ishte ndryshe nga ne. Andrea nuk fliste thujse asnjë fjalë, asnjëherë nuk bëhej kurioz se çfarë thoshim apo me se luanim ne gjatë orëve të pushimit. Ai mbante gjithmonë në dorë një zebër prej ilitiku, e vendoste mbi bankë dhe rrinte e shikonte për minuta të tëra. Kur ne bënim detyrat, mësuesja i jepte të punonte me palstelinë dhe për habinë e të gjithëve, me ca lëvizje të shpejta të gishtave, ai arrinte të bënte një tjetër zebër si lodra e tij, por këtë herë zebra ishte prej plasteline. Mësuesja na tregoi se ai i pëlqente shumë kafshët dhe në mënyrë të veçantë zebërën. Brenda një kohe të shkurtër, këndi i artistëve të vegjël të klasës, u mbush me zebra prej plasteline me ngjyra dhe madhësi të ndryshme.



Andrea herë pas here ngrihej nga banka, shkonte tek dërrasa, ose. tek këndi i zebrave, ndonjëherë kërkonte edhe të dilte jashtë. Në orë të caktuara, në bankë me të ulej mësuese Ana, e cila vinte për t'a ndihmuar Andrean. Ndonjëherë ajo na ndihmonte dhe ne. Jo gjithmonë Andrea qëndronte me ne deri në fund të mësimit, ndonjëherë shkonte tek klasa ku kishte shumë mjete e lodra, herë të tjera, babai i tij vinte e merrte me shpejt nga shkolla.

Një ditë në klasën tonë erdhi psikologjia e shkollës, së bashku me mjeken dhe punonjësen sociale. Ato na shpjeguan përmes shumë mënyrave se çfarë është autizmi,

cilat janë karakteristikat e sjelljes së fëmijëve me autizëm dhe se si mund të silleshim e të komunikojmë me bashkëmoshatarët tanë që janë me autizëm .

Ato na shpjeguan se vështirësia më e dukshme për fëmijët me autizëm shpesh ka të bëjë me fushën e gjuhës dhe të komunikimit. Të gjithë fëmijët me autizëm kanë vështirësi në ndërtimin e marrëdhënieve me të tjerët, si psh në bashkëpunimin dhe ndërveprimin me shokët, por edhe në mënyrën e sjelljes ndaj tyre. Ata mund të luajnë apo të komunikojnë në mënyrë të çuditshme, psh të rrotullojnë një lodër në formë rrethore pa pushim, të marrin mamin ose mësuesen nga dora për t'i kërkuar diçka. Asnjë fëmijë me autizëm nuk është i njëjtë me tjetrin, sikurse çdo njëri nga ne është i veçantë, i ndryshëm. Ata ditë ne mësuam se kishte shumë raste të individëve me autizëm, të cilët ishin të të suksesshëm dhe jepnin kontribute të rëndësishme në shoqëri. Pas gjithë këtyre shpjegimeve, ne i dhamë përgjigje disa pyetjeve që kishim ngritur për sjelljen dhe qëndrimin e Andreas në klasë.

Një ditë mësuesja ftoi të gjithë prindërit të vizitonin këndin e zebrave, kështu e quajtëm ne këndin ku mësuesja vendosi punimet e Andreas. Ajo u foli prindërve tanë për të, kërkoj mbështetjen e tyre në mënyrë që Andrea t'a ndjente veten sa mirë mes nesh. Ne çdo ditë e më shumë gjejmë forma dhe mënyra të reja për të komunikuar e luajtur me të. Hera – herës ai është i ngjashëm me ne në shumë drejtime, pavarësisht të veçantave që ka, e megjithatë, ai është shoku ynë i klasës, që e duam dhe na do sipas mënyrës së tij. Ne çdo ditë i urojmë mirmëngjes dhe ai na buzëqesh, duke na treguar se ndjehet mirë mes nesh.



Aktivitete

Në kuadrin e javës globale të edukimit për vitin 2014 dhe në zbatim të objektivave të projektit “Promovimi i të Drejtave të Fëmijëve në Arsim dhe Zhvillimi Tërësor i tyre”, në periudhën 4 – 10 Maj në shkollat e përfshira në projekt janë organizuar aktivitete ndërgjegjësuere e sensibilizuese me temë:

“Të drejta të barabarta , mundësi të barabarta për fëmijët me aftësi të kufizuara”.

Çfarë është Java Globale për Edukim

Fushata Globale për Edukimin (GCE) është një lëvizje e shoqërisë civile që punon për t'i dhënë fund krizës globale të arsimit, si një e drejtë e çdo fëmije Misioni i kësaj jave është për të siguruar që shtetet të veprojnë për të dhënë të drejtën e secilit për një arsimim të lirë dhe një arsimim sa më cilësor.

Në këtë kuadër, nxënësit pjesëmarrës të qeverive të nxënësve në shkollat 9 vjeçare: “Qemal Mici, Durrës, “Najzi Mastori”, Sukth, “Avni Rustemi”, Vore, “Fadil Gurmani”, Elbasan, “Vasil Belshi”. Shtermen, “Urani Rumbo”, Gjirokaster, “31 Korriku” dhe “Ali Metra”, Burrel, “Demir Gashi” dhe “Haki Stermilli”, Diber, “Sevasti Qiriazi”, Korçë, kanë organizuar dhe zhvilluar aktivitete në mbështetje të të Fushatës Globale për Edukim me pjesëmarrjen e shumë aktorëve si: prindër, mësuesë, përfaqësuesë të pushtetit lokal, të DA/ZA, në rajonet përkatëse etj. Gjatë këtyre aktiviteteve përfaqësuesë nga institucione arsimore, dhe të pushtetit lokal në rajon, kanë zbuluar pllakën simbolike të gjithëpërfshirjes, të ideuar dhe përgatitur nga vet nxënësit dhe të vendosur në ambientet e secilës prej shkollave ku u zhvilluan aktivitetet. Nxënësit kanë përcjellë mesazhin e tyre për të rritur ndërgjegjësimin dhe angazhimin e politikbërësve dhe politikzabuesëve në fushën e të drejtave për arsimim të fëmijëve aftësi të kufizuara. Mesazhi drejtuar të gjithë të pranishmëve është lexuar nga senatorët e çdo njëres prej shkollave të përfshira në projekt, duke synuar rritjen e angazhimit dhe të përfshirjes së tyre në çështjet e arsimit gjithëpërfshirës.



Mesazhi i përfaqësuesëve të qeverive të nxënësve në javën globale të edukimit

“Gjatë kësaj jave në mbarë botën janë duke u zhvilluar aktivitete sensibilizuese në kuadër të “Javës Globale për Edukim” e për t’ju bashkuar kësaj nisme edhe ne menduam të kontribuonim duke përcjellë mesazhe ndërgjegjësuese e sensibilizuese lidhur me të drejtën për arsimim të fëmijëve me aftësi të kufizuara .

Motoja e kësaj jave : Të drejta të barabarta, mundësi të barabarta është një apel universal për çdo njërin nga ne, për çdo institucion, politikan, profesionist, apo qytatar. Është koha të pyesim veten: Cili është kontributi im si qytetar, si bashkëmoshatar, si prind, si mësues, si politikan, kryetar, drejtues etj etj, në procesin e arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara? Çfarë kam bërë unë që këta fëmijë të mos veçohen, por të ndjehen të barabartë , të mos mbajnë mbi supe peshën e rëndë të stigmës dhe paragjykitimit? Si i kam mbrojtur unë të drejtat e tyre? Si i kam ndihmuar ata të rriten e të zhvillohen në mënyrë të pavarur?

Ndoshta arrijmë të marrim një përgjigje, ose ndoshta kur të largohemi që këtu secili prej nesh në vendin ku jeton, ku mëson, dhe ku punon do të mund të bëj diçka. Ndoshta arrin t’a firmosë vendimin për emërimin e mësuesës ndihmëse në shkollën tonë apo dhe në shkolla të tjera, ndoshta do guxoj t’a hedhë për diskutim mes kolegëve çështjen e buxhetit për ndërtimin e rampës në mjediset e shkollës, me siguri që do t’ thotë djalit apo vajzës në shtëpi se duhet t’a mbështesë bashkëmosharin e tij /të saj me aftësi të kufizuara, pa dyshim që do t’a ndihmoni nxënësin tuaj të mësojë pranë shokëve të tij, në të njëjtën shkollë, do të kontribuoni që muri i paragjytimeve për aftësitë dhe mundësitë e shokut apo shoqes tuaj me aftësi të kufizuara të shembet.



Të gjithë së bashku mund t'ia dalim që fëmijët me aftësi të kufizuara të jenë pjesë e kopshteve e shkollave të zakonshme si çdo bashkëmoshatar i tyre. Me fjalën, qëndrimet, sjelljen dhe përpjekjet tona mund të sjellim ndryshim në jetën e fëmijëve që për shkaqe e arsye të ndryshme, nuk mund të flasin, të ecin, të mësojnë, apo luajnë si shokët e tyre.

Le të jetë kjo ditë pikënisja ose vazhdimi i përpjekjeve tona për t'i bërë fëmijët me aftësi të kufizuara pjesë të jetës sonë me të drejta e mundësi të barabarta në fushën e arsimit, punësimit shëndetësisë e shërbimeve sociale.

E dimë që ka shumë sfida, që vështirësitë janë të mëdha, por le t'a provojmë. Zbatimi i ligjit për sistemin arsimor parauniversitar shtrun para çdo njërit prej nesh detyra dhe përgjegjësi të mëdha. Ne mund t'ia dalim që edhe vendi ynë të renditet përkrah vendeve të tjera ku vlera të tilla si toleranca, respekti, pranimi, mbështetja janë vlera të pazëvendësueshme, të prekshme, të vërteta.

A nuk duam të gjithë që fëmijët të mësojnë në shkolla gjithëpërfshirëse, që veçimi të mos ekzistojë, që çdo kush të pranohet për atë që është dhe për atë që përfaqëson? E që ky realitet të na përkasë duhet të mendojmë ndryshe, të shohim ndryshe, të sillemi ndryshe e të flasim ndryshe.

Një mënyrë të ndryshme po na e tregojnë sot nxënësit e shkollës sonë nëpërmjet mesazhit që ata kanë zgjedhur për të përfaqësuar qëndrimin e gjithw komunitetit shkollor ndaj gjithëpërfshirjes, në pllakartën që do të zbulohet gjatw aktivitetit, ndaj kemi nderin dhe kënaqësinë që t'ju ftojmë juve të zbuloni pllakën simbolike të gjithëpërfshirjes, të ideuar e përgatitur nga vet ne, dhe njëkohësisht të na premtoni se do të jeni bashke me ne në këtë rrugëtim të gjatë”.

Në mbështetje të aktiviteteve të kësaj jave edhe kryetarja e shoqatës MEDPAK përcolli mesazhin e saj për të gjithë ata që punojnë me fëmijët dhe për fëmijët, në mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të tyre.

Mesazhi i kryetares se shoqatës MEDPAK , në Javën Globale të Edukimit

“Është e vështirë të flasësh për përjetimet, pengesat, sfidat që ne prindërit ndeshim çdo ditë në rrugëtimin tonë të gjatë dhe të vështirë për të mbështetur procesin e integritetit, të përfshirjes dhe socializimit të fëmijëve tanë.

Dua t’ju them se të vetëm nuk mund t’ia dalim, ndaj unë sot nën atributin e kryetares të shoqatës “MEDPAK”, në statusin e një “nëne” dhe në pozicionin e një mësueseje me shumë vite përvojë pune dua të ndaj me ju eksperiencën dhe praktikën pozitive të kësaj shoqate , një shoqatë prindërishe që prej më shumë se 20 vitesh , e mbështetur nga organizma dhe donator të ndryshëm ka mbështetur e lehtësuar procesin e gjithëpërfshirjes në arsim të fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsim.

Shoqata “ MEDPAK” ka në fokus mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara, e si një bashkësi prindërishe e profesionistësh ne kemi përkrahur e mbështetur fuqishëm të drejtën e fëmijëve me aftësi të kufizuara për t’u arsimuar në shkolla gjithëpërfshirëse.

Ne e kemi kuptuar se si grup interesi jemi të parët që mund të ndihmojmë në shembjen e murit të pengesave, për t’i hapur rrugë arsimimit të fëmijëve tanë, e ndjejmë përgjegjësinë për të bashkuar zërat tanë, përpjekjet tona në mbrojtje të kësaj të drejte. Së bashku ne mund të ushtrojmë presion pozitiv që kuadri ligjor, i cili garanton të drejtën e fëmijëve tanë për t’u arsimuar përkrah bashkëmoshatarëve të tyre, të gjëje rrugën e zbatimit. Mbështetja jonë jeni ju, që me atributet që ju jep roli dhe funksioni juaj, me përgjegjësinë morale dhe profesionale do të bëni të mundur përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e arsimit bazë.

Hapi i parë drejt gjithëpërfshirjes ka të bëjë me ndryshimin e qëndrimeve, sjelljeve, modeleve të komunikimit kur bëhet fjalë për fëmijët me aftësi të kufizuara e më lejoni t’ju them se prezenca dhe prania juaj sot këtu më bind fuqishëm se gjithëpërfshirja është në rrugë të mbarë.

Aktualisht Shoqata “ MEDPAK” është duke punuar në 14 shkolla të vendit për të bërë të mundur përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në këto institucione, e mbështetur fuqishëm nga partneri ynë serioz Organizata “ Save the Children”. Jemi krenarë për arritjet tona, por dhe të vetëdijshëm për pengesat dhe vështirësitë e shumta me të cilat ndeshet procesi i arsimit gjithëpërfshirës, vështirësi që burojnë nga procedurat e regjistrimit, vlerësimit, hartimit dhe zbatimit të planeve edukative individual për këta fëmijë. Nëse institucionet përgjegjëse për zbatimin e kuadrit ligjor do të bashkërendonin përpjekjet me prindërit, komunitetin, aktorët e shoqërisë civile, pa dyshim që këto pengesa do të minimizoheshin.

Edhe tani që unë flas, por edhe përgjatë ditëve të tjera të kësaj jave, në 14 shkollat

ku zbatohet projekti ynë i mbështetur nga “Save the Children”, nxënësit e këtyre shkollave kanë zhvilluar aktivitete sensibilizuese e ndërgjegjësuere lidhur me parimet e gjithëpërfshirjes në arsim të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Më lejoni t’ju them se ne kemi një gjeneratë të denjë fëmijësh, të cilët e kanë pranuar dhe mbështetur të parët arsimin gjithëpërfshirës. Më besoni unë dhe stafi i projektit e kemi parë nga afër gjatë kësaj jave mbështetjen e tyre në aktivitetet që janë zhvilluar. Nxënësit e këtyre shkollave nuk kanë nguruar të përcjellin mesazhet e tyre të drejtpërdrejta për t’i thënë “ndal diskriminimit”, për t’i hapur rrugën pranimi, tolerancës, mbështetjes”. Ata kanë kërkuar vëmendjen dhe angazhimin e institucioneve përgjegjëse, kontributin tuaj.

Është e rëndësishme që institucionet, agjensitë në nivel qendror edhe lokal të bashkërendojnë përpjekjet, të kordinojnë punën në mënyrë që vizioni i shoqërisë s’ontë të jetë vizioni i një shoqërie të hapur, pranuese, ku respekti, ndihma, toleranca të përbëjnë vlera të padiskutueshme.

Ne kemi një kuadër ligjor bashkëkohor, por kjo nuk mjafton, ai ka nevojë të gjejë dritën e zbatimit. Komisionet me bazë drejtorie arsimore e shkolle duhet të jenë funksionale, të konsoliduara, aktive.

Ne kemi punonjës arsimit të përkushtuar në rrugën drejt gjithëpërfshirjes, por kjo nuk mjafton, ata kanë nevojë të rrisin e të zgjerojnë kapacitetet e tyre profesionale, të mbështeten me ekspertizë, të punojnë në grup, të përdorin një kurrikul fleksibël dhe të përshtatur me nevojat e çdo fëmije, të kenë pranë mësuesë të specializuar në fushën e arsimit gjithëpërfshirës.

Ne përpiqemi çdo ditë që ky proces të jetë në rrugë të mbarë, por le të na shërbejë kjo fushatë, kjo ditë sot si një apel, si një premtim se do të kontribuojmë pa u lodhur që situata arsimore dhe sociale e fëmijëve me aftësi të kufizuara të përmirësohet, që ata të ndjehen të barabartë, të pranuar, të mbështetur”.

Dialog me prindërit

Më lejoni të prezantoj veten

Të dashur prindër, dua t'ju them se nuk jam “dembel” as “i vonuar” jam thjesht një fëmijë me disleksi...



Disleksia nuk është një sëmundje, as një problem apo një cen, për të nuk ka një kurë, nuk shërohet sepse nuk ka vend për asnjë sëmundje! Disleksia është një karakteristikë, si të jesh djalë apo vajzë, të jesh nga një qytet i caktuar, ose nxënës në një shkollë të caktuar. Ju mund të filloni ndryshimin e kesaj praktike duke filluar nga vetja, duke zëvendësuar frazën “diagnostikuar me disleksi me frazën “identifikohet me disleksi”.

Është e rëndësishme që disleksinë të mos e shikoni apo të mos e trajtoni si një çregullim, por si një mënyrë alternative, të cilën unë e përdor për të perceptuar apo përpunuar informacionin përreth meje. Kjo mënyrë ka avantazhet dhe disavantazhet e saj.

Disleksia ndikon në shumë fusha të jetës, por nuk të pengon t'a jetosh jetën e të ndihmohesh e mbështetesh nga familja, shkolla dhe komuniteti për të zbuluar vlerat dhe aftësitë që ke.



Ndiqni udhëtimin tim

Unë jam Aleksandri dhe jam disleksik. Kur hyra në shkollë kuptova se diçka nuk shkonte me mua. Shpesh pyesja veten nëse isha i zgjuar mjaftueshëm sa edhe fëmijët e tjerë, pasi mësuesja vazhdimisht më tërhiqte vëmendjen. Kështu bënin edhe prindërit në shtëpi.

Isha i shqetësuar dhe i mërziur rreth kësaj gjëndjeje, por nuk dija ndonjë mënyrë për të shpëtuar prej saj. Doja që dikush të mi lexonte me zë të lartë pjesët me shkrim në libër apo fletore në mënyrë që të gjeja gabimet që bëja gjatë shqiptimit. Kjo ishte e pamundur sepse as mësuesja, por as mami nuk e kuptuan kurrë këtë nevojë dhe dëshirë timen. Tani që jam rritur dhe e kam kuptuar disleksinë time, mendoj se sikur shokët të mos kishin qeshur me gabimet e mia kur lexoja, do të kisha besimin e duhur tek vetja për të dalë para një publiku e për të folur me zë të lartë.



Nëse mësuesja nuk do më kishte kritikuar aq shumë për gabimet që bëja, tani do të ndihmoja fëmijët e tjerë me disleksi dhe prindërit e tyre që të mos ndjehen vetëm. Ka shumë fëmijë e të rritur kudo në botë që jetojnë të lumtur edhe pse janë disleksikë. Nëse ju prindërit e mi nuk do më kishin etiketuar si një “fëmijë dembelë”, une sot do ju kisha treguar të gjitha aftësitë e mia në fusha të tjera. Dhe nëse unë vet nuk do isha rritur se një fëmijë që ka provuar orë e çast ndjenjën e turpit e të dështimit, sot do t’ju thoja se jam krenar për disleksinë time. Ju mund të përpiqeshit më shumë të njihnit pikat e mia të forta dhe ato të dobta, kështu që ju do të më njihnit më mirë dhe do të besoni tek mua e do prisnit më shumë prej meje. Nëse nuk do t’a kisha fajësuar veten për disleksinë time, (e si mund të isha unë fajtor, fajtor njësoj si ai që vjedh apo gënjen), do t’ju thoja sot se është e rëndësishme të ndjehesh mirë me veten, t’a duash dhe t’a pranosh veten ashtu si je, si dhe të të duan e të të pranojnë pa kushte. Më ka mërzhitur e trishtuar fjalja që dëgjoja vazhdimisht: Nuk është normal” E çfarë është normalja...?...A mund të ma thoni?...

U përpoqa gjatë gjithë jetës sime t’a fsheh faktin se jam disleksik, e harxhova të gjithë energjinë time në fshehjen e këtij fakti, kisha frikë t’a tregoja, t’a prezantoja veten si të tillë. Kjo është e turpshme, të fshehësh veten. Ndaj më lejoni sot t’a prezantoj veten time.



Prindër: Mos harxhoni kohë duke u shqetësuar për gabimet që fëmijët tuaj me disleksi bëjnë kur shkruajnë apo kur lexojnë, por përqendrohuni të ripërtërinë besimin e tyre dhe t’i ushqeni dashurinë për librat, për të mësuar, kënaqësinë që buron nga të lexuarit, edhe pse do të jenë gjithmonë me disleksi. Konsiderojeni disleksinë e fëmijës tuaj si gjuhën e tij amtare. Që fëmijët tuaj të jenë të sukseshëm ndihmohini ata të përfshihen e të angazhohen në bashkëbisedime me njëri-tjetër, të cilët nuk dinë shumë rreth disleksisë. Mos harroni që askush nuk lind me imunitet ndaj disleksisë.

Bëni të pamundurën që fëmijët tuaj të mos ndjehen të përjashtuar. Mësoni më shumë rreth disleksisë. Unë e kam shpjeguar kështu disleksinë time.

Shokët e mi "lexojne me sy", ata që kanë problem me shikimin përdorin alfabetin Brail, ndërsa unë lexoj me vesh, pra unë kam nevojë t'a dëgjoj tekstin që kam për të lexuar dhe këtë mund t'a bëni ju prindërit e mi, magnetofoni ose programi i kompjuterit tim, të cilin e kam instaluar kohet e fundit.

Prindër jepini fund frikërave dhe pasigurive tuaja. Unë e di cila është lista e frikërave që ju keni:

"Unë kam frike se fëmija im nuk është i zgjuar si të tjerët".

"Ndoshta nuk do të arrijë të shkojë kurrë në universitet".

"Une kam frikë se femija im nuk do të pershtatet ndonjëherë me shkollën, me librat, me mësimet"

"Jam e frikësuar se do t'a tallin gjithmonë duke i thënë : ti je i vonuar, ti nuk di"

"Unë kam frikë se njerëzit gjithmonë do të më gjykojnë mua dhe fëmijën tim"

"Do ndjehem keq kur të tjerët përreth do tregojnë arritjet e fëmijëve të tyre, kur dikush do të thotë: e dini djali ynë ka mësuar të lexojë, edhe pse është vetëm 5 vjeç, jam shumë e emocionuar për këtë".

"Unë kam frikë femija im nuk do të jete si unë".

"Nuk dua që fëmija im të përfundojë në një shkollë speciale"

Mendoni që fëmija juaj është i veçantë, i pakrahasueshëm, është vetvetja dhe do të gjejë vendin e tij në shoqëri. Ndhimjojeni të dojë veten, të pranojë realitetin dhe të shkojë përpara.....



Adresa: Rruga: "Sh.Ishmi", Pallati 38,
Shkalla1, Apt 2, Tirane
Tel : ++ 355 4 23 45 028
Mobile : 069 22 08 985 / 068 25 78 002
E-mail : info@medpak.org
website: www.medpak.org



Save the Children

Rruga "Komuna e Parisit"
Lagjia 8, Pallatet 1 Maji, Vila "Lami"
P.O.Box 8185
Tirana Albania
Tel: +355 4 2261 840
+355 4 2261 929
+355 4 2266 227
Fax: +355 4 2263 428
E-mail: scalbania@scalbania.org
Web side: www.scalbania.org